





Kanton Bern
Canton de Berne

Informacione përr prindërit rreth Basisstufe Elterninformationen Albanisch

Bildungs- und Kulturdirektion



Basisstufe



Më e rëndësishmja me pak fjalë

Das Wichtigste in Kürze

Në kantonin e Bernës fëmijët shkojnë dy vjet në kopshtin e fëmijëve dhe pastaj ata hyjnë në vitin e parë të shkollës primare. Modeli „Basisstufe“ i lidh dy vitet e para të kopshtit të fëmijëve dhe vitin e parë dhe atë të dytë të shkollës primare. Pra në klasat e shkollës Basisstufe fëmijë në moshën katër deri tetë vjeç mësohen bashkërisht. Mësimi orientohet në gjendjen e zhvillimit dhe të të mësuarit të fëmijëve (dhe jo në moshën e tyre) dhe bëhet në grupe fleksible mësimi, të përziera në moshë. Kalimi nga veprimtari zbavitëse në të mësuarin e orientuar në detyra bëhet gradualisht.

Fëmijët e kalojnë shkollën Basisstufe, si rregull, brenda katër viteve dhe pas arritjes së objektivave të të mësuarit ata hyjnë në vitin e tretë të shkollës së shkollës primare. Sipas kushteve individuale dhe rrugës së vetë të të mësuarit ndjekja e shkollës Basisstufe mund të zgjasë edhe tre ose pesë vjet.

Një klasë e shkollës Basisstufe përbëhet nga 18 deri në 24 fëmijë dhe mësohet pjesërisht njëkohësisht nga dy forca mësimore.

Kuptimi i zhvillimit dhe i formimit

Entwicklungs- und Bildungsverständnis

Zhvillimi i fëmijëve bëhet në mënyrë të ndryshme. Fëmijët guxojnë t'i bëjnë hapat e tyre të para në kohë të ndryshme dhe i flasin fjalët e tyre të para në moshë të ndryshme. E ngjashme është edhe me aftësi dhe shkathtësi të tjera. Në shkollën Basisstufe kjo gjendje individuale e zhvillimit merret parasysh në mënyrë të veçantë duke e përshtatur mësimin, ofertën e lojërave dhe të të mësuarit me nevojat e secilit fëmijë.

Grupe mësimore, të përziera në moshë

Altersgemischte Lerngruppen

Në shkallën Basisstufe fëmijë në moshën katër deri tetë vjeç mësohen bashkërisht. Meqë hyjnë fëmijë me kushte dhe aftësi të ndryshme, mësimi nuk orientohet sipas moshës së tyre, por sipas zhvillimit të tyre, nevojave dhe mundësive të tyre të të mësuarit. Grupet mësimore, të përziera në moshë, ofrojnë një fushë të vyeshme mësimore për kontaktin me përgjegjësi me fëmijë të tjerë. Fëmijët mund të mësojnë nga njëri-tjetri dhe me këtë thellojnë diturinë dhe aftësinë e tyre.

Lojëra dhe mësimi

Spielen und Lernen

Në shkallën Basisstufe kalimi nga veprimtari zbavitëse në të mësuarin të orientuar në detyra bëhet gradualisht: Loja në formë mësimi zëvendësohet nga të mësuarit në formë loje. Me këtë mundësohet që fëmijët të nxiten, sipas zhvillimit të tyre personal, emocionalisht, shoqërisht dhe në fusha shkollore.

Leximi, shkrimi dhe llogaritja

Lesen, Schreiben, Rechnen

Për hyrjen në lexim, shkrim dhe llogaritje nuk është vendimtare moshë ose kalimi në klasën e parë të shkollës, por gjendja e zhvillimit të fëmijëve. Fleksibiliteti i shkallës Basisstufe mundëson që fëmijët lexojnë, shkruajnë dhe llogarisin atëherë, kur ata janë të gatshëm për këtë. Lidhur me këtë kureshtja dhe gëzimi për të mësuar nuk duhet të frenohen, por duhet të nxiten. Ky parim vlen edhe për lëndët e tjera mësimore „Natur, Mensch, Gesellschaft (NMG)” (natyra, njeriu, shoqëria), krijimi, muzika dhe sporti.

Objektivat dhe përmbajtjet e mësimimit

Ziele und Inhalte des Unterrichts

Mësimi në Basisstufe e fëmijëve orientohet në Lehrplan 21. Lehrplan u shërben forcave mësimore nga kopshti i fëmijëve deri në vitin e 9-të të shkollës si busull, i cili i mbështet ato në planifikimin e mësimimit.

Personat mësimdhënës

Lehrpersonen

Ekipi i shkallës Basisstufe disponon aftësinë e mësimdhënies për kopshtin e fëmijëve dhe shkallën primare. Personat mësimdhënës punojnë pjesërisht në formën Teamteaching, d.m.th. ata mësojnë njëkohësisht në të njëjtën klasë. Ata e planifikojnë së bashku mësimin me qëllimet, përmbajtjet dhe format e tij të punës dhe e vlerësojnë atë pas kryerjes. Ata mbajnë bashkërisht përgjegjësi dhe përcaktojnë një ndarje të qartë të roleve. Ata i nxisin fëmijët me forma të ndryshme të lojërave, të të mësuarit dhe të mësimdhënies dhe venë në dispozicion një ofertë të larmishme të materialeve zbavitëse dhe mësimore. Fëmijë, të cilët në fusha të veçanta kanë nevojë për nxitje të veçantë, p.sh. në zhvillimin gjuhësor ose motorik, përkrahen nga specialistë shtesë.

Format e organizimit të shkollimit të fëmijëve në moshën 4 deri 8 vjeç

Organisationsformen der Schuleingangsphase

Kopshti i fëmijëve është i obligueshëm dhe pjesë përbërëse e shkollës fillore. Ai zgjat dy vjet.

Për shkollimin e fëmijëve në moshën 4 deri 8 vjeç komunat mund të mbajnë kopshte fëmijësh, klasa të shkallës Basisstufe ose Cycle élémentaire.

Informacione të tjera rreth shkollës fillore

Weitere Informationen zur Volksschule

www.be.ch/volksschule

Bildungs-und Kulturdirektion
Amt für Kindergarten, Volksschule und Beratung
akvb.bkd@be.ch
Auflage 2022

Figura e kopertinës është një vepër e përbashkët e klasës së projektit Basisstufe Köniz-Buchsee.